

Kol Hysenaj




PROKUROR PRANË PROKURORISË
SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2017



Pasuria Bruto nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 20.5 herë.

+ 2,776,241 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete
në Bankë

1,352,300

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

Pasuritë e
Luajtshme

8,951,320

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

Pasuritë e
Paluajtshme

1,990,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

30,553,750

Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	15,420,898	23.98%
Paga e familjarëve	13,245,541	20.60%
Të ardhura nga aktiviteti privat në emër të bashkëshortes	17,300,000	26.90%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	13,751,100	21.38%
Të ardhura nga shitblerja e automjeteve	4,391,066	6.83%
Dhurata në Cash	200,000	0.31%
Total	64,308,605	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

3 Me Probleme
11 Pa Probleme

Subjekti Kolë Hysenaj rezulton me pasuri të pajustificuar në tre vite të deklaramit të pasurisë: në vitin 2011, 2015 dhe 2016 përkatësisht në shumat 3,125,364 lekë, 3,065,899 lekë dhe 11,715,491 lekë, pa llogaritur shpenzimet e konsumit familjar.

Viti 2016 shënon një rritje prej 125,000 euro në pasuri të paluajtshme, burimi i cilit janë të ardhurat ndër vite. Subjekti dhe familjarët e tij ndër vite deklarojnë të ardhura të mjaftueshme për ta mbuluar këtë investim të kryer, por këto kursime nuk janë deklaruar si të tilla në rubrikën e aseteve në fund të çdo periudhe. Nga viti 2007-2016, bashkëshortja e subjektit deklaron të ardhura nga aktiviteti privat bar-kafe. Në vitin 2016 saktëson që: "në deklaramet e mëparshme gabimisht jam referuar në lekë të vjetra", pa cilësuar cilat janë vitet apo shumat që janë të pasakta.

Në deklaramin Para Fillimit të Detyrës subjekti ka deklaruar huamarrje nga vëllai dhe kunati, si burim për blerjen e shtëpisë në shumat 300.000 lekë dhe 1,300,000 lekë. Në 2006 subjekti shprehet se borxhi ndaj vëllait prej 200,000 lekësh i është dhuruar nga ky i fundit; ndërsa shlyerja ndaj kunatit është realizuar në 2 këste në vlerën 1,100,000 lekësh, e cila nuk përputhet me shumën e deklaruar fillimisht.

Në vitin 2011 subjekti deklaron kontratë shitblerje toke me sip 2000 m2 në fshat me çmimin 11,270,000 lekë, si dhe ndërtim të një shtëpie një kat me çati me sip 270 m2, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë lidhur me koston e ndërtimit.

Gjatë viteve të deklaramit subjekti realizon transaksione të shumta shitblerje automjeteve apo shkëmbime me çmim shitje më të lartë se çmimi i blerjes.